



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality Assambly  
Hani i Elezit



01/Nr. 4723/2023  
Data : 08.06.2023

### PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e -V- për vitin 2023 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 18.05.2023 me fillim pune ne ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoreshë për Administratë), **Lindita Ballazhi** (Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa), **Nexhmedin Daci** (Drejtëor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtëor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Arsim Dernjani** (Drejtëor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Hisni Luri** (Drejtëor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Bashkim Sopa** (Zyrtar për Informim), **Rezart Mehmeti** (Përfaqësues i OSB-së).

#### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Draft Strategjia për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2023-2026 të Komunës së Hanit të Elezit.
3. Draft plani i veprimit për Transparencë 2023-2026 i komunës së Hanit të Elezit.
4. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit.
5. Të ndryshme.

**Kryesuesi thekson:-** për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi thekson:-** për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## **2. Draft Strategjia për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2023-2026 të Komunës së Hanit të Elezit.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Natyra Kalisi** thekson:- strategjia e parqet organizimin e administratës komunale, kornizën ligjore për këtë strategji si dhe gjendjen aktuale për informim dhe komunikim duke kaluar pastaj edhe te objektivat e komunikimit . Strategjia është bërë për shkak të rritjes së transparencës komunale sepse si komunë jemi të angazhuar në këto sfera si në informimin e qytetarëve , rritja pjesëmarrjes së qytetarëve në debate publike dhe dëgjime buxhetore. Materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë pyetje mund të parashtroni.

**Refet Kalisi** thekson:- sa i përket takimeve është mirë me pasur ndonjë broshurë për me i joshur qytetarët që sa më shumë me marr pjesë nëpër debate.

**Natyra Kalisi** thekson:- ne kemi paraparë vendosjen e monitorëve nëpër zonat urbane dhe rurale për informim të aktiviteteve të komunës në mënyrë që të jemi sa më afër qytetarëve.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### **U VOTU DRAFT STRATEGJIA PËR INFORMIMIN KOMUNIKIMIN DHE PJSÉMARRJEN E QYTETARËVE 2026-2026 TË KOMUNË SË HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

## **3. Draft plani i veprimit për Transparencë 2023-2026 i komunës së Hanit të Elezit.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Natyra Kalisi** thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam. Ky është hartuar në bashkëpunim me OSB-në . Nëse keni ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### **U VOTU DRAFT PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË 2023-2026 I KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

## **4. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci** thekson:- arsyet e ndotjes i dimë të gjithë që vijnë prej ndotjes prej “Sharrcem”, qarkullimit të madh të veturave, në magjistrale, përdorimi i masës drusore për ngrohje gjatë sezonit dimërorë. Në material i kam paraqitur rezultate e monitorimit të ajrit nga stacioni monitorues i ajrit. Krahasimet i kam bërë me vitin 2021 dhe ka pak a shumë ndryshime të përmirësimit të ajrit. Kompania “Sharrcem” e ka dërguar raportin për mbrojtjen e mjedisit të cilin ua kam përcjell.

**Sherif Berisha** thekson:- stacioni i monitorimit të ajrit duhet të jetë në afersi të kompanisë “Sharrcem” në mënyrë që ta shohim se sa është ndotja. Sipas informatave që kemi me një orë në ditë digjen 6000 tonë lëndë për çiment dhe ku del ajo. Shihen që i kanë vendosur filtrat dhe ka përmirësimë por djegëja është e madhe. Komuna duhet t’i caktonte dy apo më shumë persona që të monitorojnë çështjen e ndotjes brenda kompanisë “Sharrcem” dhe propozoj që të bëhet një gjë e tillë. Në shtetin e Kroacisë komuniteti e kishte të caktuar një person i cili e bënë monitorimin për komunitet.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- sa i përket stacionit të monitorimit të ajrit jemi në proces të zhvendosjes por janë procedurat dhe për me zhvendosur sa më afër kompanisë është e rregulluar me Ligj dhe është pesëqind metra në largësi. Ministria e ambientit e kontrollonë stacionin e monitorimit të ajrit dhe është përgjegjësi e Ministrisë me vepruar nëse ka ndotje por ne do të mundohemi me krijuar komunikim. Për me përcaktuar ndonjë person për monitorim të ambientit duhet të shikojmë se a përcaktohet me Ligj sepse janë rregullat e monitorimit përmes inspektoratit.

**Sherif Berisha** thekson:- ndotje ka se po që se marrim ndonjë letër të bardhë dhe e vendosim mbi makinë dhe në mëngjes dhe ata të cilët janë profesional mund të bëjnë analiza. Është mirë që të ndërmarrim në mënyrë që mos të pësojnë gjeneratat e reja.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- të gjithë po kërkojmë që me pasur shëndet dhe është detyrim i institucionit për ruajtjen e shëndetit por aty ku nuk kemi kompetenca ligjore është e pamundur sepse ne nuk mundemi me krijuar një konflikt me kompaninë. Është ministria përkatëse që merret me monitorim dhe inspektorati duke u bazuar në kërkesa dhe vërejtjet e qytetarëve të cilat na i përcjellin.

**Refet Kalisi** thekson:- sa i përket ndotjes ka ndotje po unë nuk jam në atë që kompania "Sharrcem" me u myllur se është gjigantë por është mirë që me ndikuar që me pasur përmirësim të ndotjes. Kompania "Sharrcem" duhet t'i mbjellë etazhat që ka pasur në plan për me i mbjell sepse e freskon pak ajrin. Pavarësisht që ka ndotje prej automjeteve edhe pluhuri i "Sharrcemit" vërehet në mëngjes edhe pse nuk është sikur ka qenë më herët por ndotje ka. Me dërguar një person nga komunitete kompania nuk e di a e pranon sepse është private.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U VOTU INFORMATA MBI MBROJTJEN E MJEDISIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

##### 5.Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sherif Berisha** thekson:- kërkoi nga drejtoria për arsim që të na njoftojë rrëth përgatitjeve përfestival.

**Hisni Luri** thekson:- kemi zhvilluar procedurat për garat sportive dhe po ashtu sa i përket festivalit jemi tu munduar që me i kryer procedurat dhe forma më të mira që mos me pasur komplikime që me zhvilluar pjesën e festivalit.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- afër 18 shoqëri kulturore artistike deri më tanë e kanë konfirmuar pjesëmarjen. E di që bisedohet çështja e ujit të Dimcës por jemi në fazën e fundit të pranimit teknik të asaj fabrike dhe ka qenë shumë problem me i bërë bashkë faktorët të cilët kanë investuar në këtë fabrikë dhe brenda këtyre ditëve po mundohemi që me bërë nënshkrimin për pranimin teknik të kësaj fabrike. Komuna është e gatshme që të ndajmë mjete për me zgjidhur këtë problem. Në të ardhmen do të shohim për me i shtuar kapacitete të ujit.

**Refet Kalisi** thekson:- po më vjen mirë që po i vjen fundi dhe shpresojmë të bëhet mirë sepse të gjithë e kemi pritur për shkak se është investuar në atë pjesë.

**Sherif Berisha** thekson:- te çështja e ujit duhet të ndajmë mjete financiare edhe për shtim të kapaciteteve të ujit. Një bisedë që kam pasur me këshillat e fshatrave u ankuani që ju ka ndalur pagesa dhe përgjigjja nga ekzekutivi ka qenë që Ministria e Financave i ka ndërprerë këto pagesa.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- e kemi edhe kategorinë buxhetore për shtim të kapaciteteve të ujtit.

**Refet Kalisi** thekson:- trotuari që është tu rregulluar te Ura e Seçishtës më është dukur pak i ngushtë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- është brenda standardeve që parashihen.

**Natyra Kalisi** thekson:- i kemi përcjell ndryshimet në lista të pagave që bëhen edhe për këshillat lokale dhe komitetet konsultative por Ministria ka vendosë që mos me i pagur me ligjin e ri të pagave. Ju kam drejtuar me shkresë Ministrisë dhe më kanë sugjeruar që me kontaktuar me Ministrinë e punëve të brendshme dhe ma kanë përcjell një qarkore buxhetore. Është një diskrepancë e ligjeve për shkak se udhëzimi administrativ parasqeh që duhet të ju paguhet mëdita sikur komitetete konsultative.

**Kryesuesi thekson:-** për çështje të pagesës mendoj që Ministria përkatëse ka me bërë ndonjë zgjidhje për shkak se nuk është fajt i komunës çështja e mos pagesës. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të myllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 12:25.

## Procesmbajtësi

Avni Bushi

Ayni Bushi

